



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

# RAPORTI I VEPRIMTARISË

## PËR VITIN

### 2018

## Përmbajtja

Akronime .....	2
1. Hyrje .....	3
2. Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.....	4
2.1. Përbërja e BMP .....	4
2.2. Të drejtat dhe detyrat BMP .....	5
3. Aktivitetet kryesore të realizuar gjatë vitit 2018 .....	7
3.1. Projekte.....	7
3.2. Rregullore të reja.....	8
3.3. Rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës .....	11
3.4. Provimet e aftësimit profesional .....	11
4. Vështrimi i përgjithshëm mbi tregun e auditimit.....	14
4.1. Cilësia në auditim.....	14
5. Inspektime me fokus kontrollin e cilësisë .....	17
5.1. Gjetje të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë .....	19
5.2. Gjetje të anagazhimeve individuale .....	20
6. Rekomandime për audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit.....	23
6.1. Rekomandime për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë.....	23
6.2. Rekomandime për angazhimet e auditimit.....	24
7. Masat e marra ndaj subjekteve të ndryshëm.....	26
8. Planifikimi .....	27
8.1. Plani i punës 2019 .....	27

© 2018

Ky raport dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë e drejtë autori. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për Bordin e Mbikëqyrjes Publike në Shqipëri. Kopjimi dhe përhapja e të dhënave apo përdorimi tregtar i këtij raporti nuk është i lejuar përveç kur jepet miratim me shkrim. Është i ndaluar vendosja e këtij raporti në faqe interneti edhe kur kjo bëhet pa pagesë, nëse nuk është marrë aprovimi paraprak nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Përdorime të tjera që nuk parashikohen në këtë seksion janë të lejuara vetëm nëse burimi i informacionit citohet me saktësi “Bordi i Mbikëqyrjes Publike i Shqipërisë”.

## Akronime

AL	Auditues Ligjorë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BMP	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
BSH	Banka e Shqipërisë
BSNEPK (IESBA)	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël
EKR	Ekspert Kontabël i Regjistruar
EVM (SME)	Entitet i Vogël dhe i Mesëm
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IFIAR	Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Auditimit
KIDB	Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike
KM	Kontabilist i Miratuar
KPAP	Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale
NIP	Njësi me Interes Publik
NUIS (NIPT)	Numri Unik i Identifikimit të Shoqërisë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKK (NAS)	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SNA (ISA)	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKC1 (ISQC1)	Standardi Ndërkombëtar i Kontrollit të Cilësisë 1
SNRF (IFRS)	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

## 1. Hyrje

Ky raport paraqet punën e zhvilluar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) përgjatë vitit 2018, për të krijuar një mjedis në përputhje me kërkesat ligjore dhe me standardet ndërkombëtare në fushën e dhënies së sigurisë nga audituesit ligjor, shoqëritë e auditimit, profesionistët kontabël të miratuar si dhe organizatat përkatëse profesionale.

Puna e BMP gjatë vitit 2018 u përqendrua kryesisht në drejtim të mbikëqyrjes së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator duke hartuar një sërë rregulloresh dhe metodologjish të reja.

Veprimtaria e BMP u fokusua edhe në drejtim të forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të institucionit për të realizuar mbikëqyrje sa më efektive, si një domosdoshmëri për të arritur standardet më të larta në profesionin e auditimit dhe raportimit financiar, duke e parë këtë zhvillim të lidhur ngushtë dhe me procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Miratimi dhe zbatimi i manualeve metodologjike bashkëkohore, si ai për kontrollin e sigurimit të cilësisë së auditimit për vitin 2018, ka luajtur një rol kyç në përmirësimin e kuadrit rregullator dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BMP.

Viti 2018 u karakterizua nga një ndërtim i marrëdhënieve dhe bashkëpunim i ngushtë me rregullatorët homologë apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator. Bashkëpunimi ndërkombëtar me homologët në Evropë ka kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira mbikëqyrëse dhe rregullatore.

BMP, edhe gjatë këtij viti u asistua nga ekspertët ndërkombëtar në kuadër të projektit "Përmirësimi i Cilësisë së Auditimit nëpërmjet forcimit të sistemit të mbikëqyrjes".

Gjithashtu, në këtë raport janë adresuar disa prej rreziqeve kryesore në dhënien e sigurisë dhe rekomandimet përkatëse në zbatim të kuadrit rregullator dhe standardeve ndërkombëtare.

## 2. Përbërja dhe detyrat e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

BMP u krijua rishtazi në tetor 2009 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Ndryshimet e reja ligjore në ligjin 47/2016 përmirësuan ndjeshëm rolin e BMP duke pasqyruar vizionin e institucioneve homologe të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e rregullores 537 të BE.

Pas këtyre ndryshimeve, BMP ka marrë statusin e autoritetit të pavarur rregullator duke realizuar mbikëqyrjen publike të profesionit të auditimit dhe shoqërive të auditimit, si drejtpërdrejt, ashtu edhe nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. BMP është gjithashtu autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe rregullimin e profesionit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse.

Përmirësimi i mjedisit të auditimit nuk do të ishte i mundur pa burimet njerëzore të mjaftueshme dhe të kualifikuara. Bazuar në përcaktimet e ligjit të sipërpërmendur dhe me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.786/2016, i ndryshuar, u mundësua krijimi për herë të parë i një strukture mbështetëse të angazhuar me kohë të plotë me qëllim realizimin dhe ndjekjen në vazhdimësi të veprimtarisë së BMP. Aktualisht, nën konsulencën e ekspertëve ndërkombëtarë në përcaktimin e kriterëve për inspektorët dhe stafin mbështetës, BMP ka një personel prej 9 ekspertë të kualifikuar duke përfshirë katër inspektorë të lartë të sigurimit të cilësisë.

Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionalë të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publike në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik.

Objektivi kryesor i BMP është të rrisë sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik. Në ushtrimin e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës, BMP udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

### 2.1. Përbërja e BMP

Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga pesë anëtarë jo-praktikues, të cilët janë ekspertë në fusha të lidhura me auditimin ligjor, emëruar nga Ministri përgjegjës për financat, me mandat për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur jo më shumë se dy herë. Anëtarët e Bordit janë përzgjedhur bazuar në kriterë të përcaktuara dhe përmes një procedure konkurrence të

pavarur dhe transparente bazuar në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar; dhe VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” e ndryshuar; si edhe në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.3.2017 “Për emërimin dhe mandatimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 15 mbledhje dhe janë marrë 29 vendime me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të parashikuara në ligj. Vendimet e Bordit janë marrë në transparencë të plotë, duke respektuar parimin e kolegjalitetit.

## **2.2. Të drejtat dhe detyrat BMP**

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimi i profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar ", i ndryshuar, Neni 5, BMP ka këto të drejta dhe detyra:

- harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale (KPAP) dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
- mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- harton dhe Miraton Rregulloren e Kontrollit të Cilësisë dhe manualin përkatës lidhur me kontrollin e cilësisë;
- mbikëqyr procesin e kontrollin të cilësisë dhe zbatimin e dispozitave të rregullores së Kontrollit të Cilësisë;
- mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- mbikëqyr përmes komisioneve të SM veprimtarinë e Komisioneve të Investigimit të Organizatave Profesionale;

- kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
- shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
- shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;
- miraton akte të tjera rregullatorë, të cilat janë në kompetencën e tij;
- shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij;
- miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

### 3. Aktivitetet kryesore të realizuar gjatë vitit 2018

#### 3.1. Projekte

##### 3.1.1 Projekti EQ-FINREP

Gjatë vitit 2018 BMP ka realizuar disa aktivitete fillestare të nevojshme për realizimin e objektivave specifike të vitit të parë dhe në vijim, të cilat përfshinin edhe një projekt pilot i zbatuar nga Banka Botërore. BMP është asistuar nga dy ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësues të PKF Italia, Z. Andrea Bonetti dhe Z. Michele Amarantesi pjesë e projektit pilot "Përmirësimi i Cilësisë së Auditimit nëpërmjet forcimit të sistemit të mbikëqyrjes" Ref. No. AL-EQ-FINREP/IL1/CS/CQS".

Bazuar në mandatin e BMP të parashikuar në ligjin për auditimin, ekspertët ndërkombëtarë përgatitën një dokument strategjik në të cilin janë paraqitur objektivat e BMP. Në këtë dokument janë konsideruar të gjithë përgjegjësitë e BMP dhe janë prezantuar një listë me prioritete për vitin e parë të aktivitetit mbikëqyrës dhe për periudhat e ardhshme. Në të është përfshirë dhe plani vjetor i punës si pjesë e planit të punës afat-mesëm (4 vjeçar), në të cilin përshkruhen aktivitetet që duhet të realizohen, alokimi i burimeve njerëzore dhe skeduli i orëve të punës.

Konsulentët asistuan BMP nëpërmjet tre pikave kyç:

1. Asistencë teknike për të hartuar planin strategjik të zhvillimit të BMP-së, dhe mbështetje për inspektorët dhe anëtarët e Bordit për të realizuar me efektivitet detyrat e tyre mbikëqyrëse, si edhe trajnime të ndryshme në vendin e punës;
2. Asistencë teknike për BMP, BSH dhe AMF për të vendosur një bashkëpunim efektiv për sigurimin e cilësisë së auditimeve në njësitë ekonomike të sektorit financiar, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të njërive ekonomike me interes publik (NIP), dhe;
3. Asistuan BMP dhe strukturën mbështetëse për të realizuar 15 inspektime të auditimeve të njërive ekonomike në sektorin financiar dhe NIP-e të tjerë, si dhe asistuan në nxjerrjen e konkluzioneve të mëtejshme.

Inspektorët e BMP, në kuadër të projektit pilot, u asistuan nga ekspertët italianë për të planifikuar dhe kryer inspektimet në terren, bazuar në metodologjinë dhe procedurat e përfshira në "Metodologjinë për kontrollin e sigurimit të cilësisë së auditimit ligjor" e miratuar nga BMP. Inspektimet në vend të shoqërive të auditimit dhe angazhimet e auditimit të përzgjedhura për



rishikim u inspektuan nga tre inspektorë të BMP me asistencën e dy ekspertëve duke zhvilluar një proces eficient dhe transparent.

Në përfundim të inspektimeve, BMP, me asistencën e ekspertëve, hartoi raportin individual për secilën prej shoqërive audituese të inspektuara, i cili përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e shoqërisë brenda kontekstit të tregut të dhënies së sigurisë në përgjithësi. Inspektimi sipas metodologjisë dhe SNKC 1 përqendrohet në përgjegjësitë e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit në drejtim të zbatimit sa më rigoroz të standardeve dhe kërkesave ligjore në auditim.

Procesi i dërgimit të raporteve është ende në vazhdim. Megjithatë, në seksionin 5 janë përmbledhur disa nga gjetjet kryesore të hasura gjatë këtij procesi.

### **3.2. Rregullore të reja**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike gjatë vitit 2018, në funksion të forcimit të integritetit të institucionit, por edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse ndërmori një sërë hapash si në drejtim të miratimit të rregulloreve të reja, ashtu edhe të amendimit të atyre ekzistuese. Kështu u miratuan dhe u rishikuan rregulloret si më poshtë.

#### ***3.2.1 Rregullorja e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale***

Bazuar në ligjin 47/2016 u krijua komisioni për testimin dhe certifikimin e audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar. Deri në fund të vitit 2017 u hartua drafti i parë i rregullores për funksionimin e këtij komisioni, i cili më pas i është kaluar për diskutim anëtarëve të Bordit dhe palëve të interesit për të marrë edhe mendimet e tyre. Rregullorja nr.2 “Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” është miratuar më datë 22/02/2018.

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së funksionimit të KPAP dhe mënyrës së mbikëqyrjes së procesit të testimit dhe vlerësimin të kandidatëve për AL dhe KM. Në të parashikohen edhe rregullat dhe kriteret e përgjithshme mbi bazën e të cilave përgatiten të gjitha aktet, rregullat dhe vendimet që dalin në zbatim të kësaj rregullore nga BMP, KPAP si dhe organizatat profesionale të parashikuara në dispozitat e kësaj rregullore.

Një nga çështjet kryesore që parashikohen në të janë rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen dhe organizimin e procesit të testimit dhe certifikimit të kandidatëve për auditues ligjorë (AL) dhe kontabilist të miratuar (KM).

### ***3.2.2 Rregullorja e brendshme e Strukturës Mbështetëse të BMP***

Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me ligjin për auditimin dhe parashikon organigramën e strukturës mbështetëse dhe mënyrën e funksionimit të saj. Rregullore është miratuar më datë 29/03/2018 dhe në të parashikohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të strukturës mbështetëse, përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat e stafit sipas pozicioneve të punës si inspektorë për AL, inspektorë për KM, stafi administrativ. Në këtë rregullore janë të mirëpërcaktuara ndarjet e detyrave realizimi i çdo procesi pune, si dhe raportimi në nivel hierarkik.

### ***3.2.3 Rregullorja e investigimit dhe disiplinës***

Një hap tjetër i rëndësishëm në realizimin e vizionit mbikëqyrës të BMP ishte edhe miratimi i rregullores nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore” në të cilën janë parashikuar masat disiplinore në vijimësi të procesit të kontrollit të cilësisë. Procesi i investigimit është i rëndësishëm për të hetuar procesin e ofrimit të shërbimit të auditimit dhe sigurimin e cilësisë për interesin publik. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore nga ana e BMP; të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e palëve në këtë proces; të përcaktojë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të procesit të investigimit dhe marrjes së masave disiplinore të BMP, si dhe parimet e përgjithshme për funksionimin e komisioneve të investigimit dhe disiplinës së organizatave profesionale, subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.

Në të parashikohen dispozitat që rregullojnë vendosjen e masave disiplinore ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar, si edhe zbatimin e tyre nga ana e BMP në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kjo rregullore gjithashtu parashikon dispozitat që rregullojnë marrjen e masave disiplinore ndaj të gjitha subjekteve të tjera të cilat janë subjekt i drejtpërdrejt ose indirekt i mbikëqyrjes së BMP-së, duke përfshirë edhe subjektet që bien ndesh dhe shkelin ligjin për auditimin; investigimin e sjelljeve të gabuara të shoqërive të auditimit, audituesve ligjorë, kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar dhe subjekteve të tjera të mbikëqyrjes mbi bazën e informacioneve të besueshme dhe kuadrit rregullator në fuqi; si dhe verifikimin e ankesave të paraqitura pranë BMP nga persona apo subjekte të tjera.

### ***3.2.4 Rregullore për Procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale***

Më datë 31.05.2018 është miratuar rregullorja nr. 6 për “Procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist i

miratuar”. Kjo rregullore ka për objekt procedurat e testimi të njohurive në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale për të marrë titullin AL dhe KM.

Në të parashikohen edhe sistemet e vlerësimit dhe të shpalljes së rezultateve të kandidatëve, për AL dhe KM, për çdo disiplinë, si dhe administrimi i materialeve të provimeve.

### ***3.2.5 Rregullorja për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor***

Më datë 02/10/2018 është miratuar rregullorja nr. 7 për “Procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”, e cila përmban metodologjinë e kontrollit të cilësisë nga ana e BMP për AL. Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian nën asistencën e konsulentëve ndërkombëtarë. Gjithashtu, në këtë rregullore parashikohen në mënyrë të detajuar politikat dhe procedurat për të ndërtuar një bashkëpunim efikas midis BMP dhe Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), në kuadër të procesit të dhënies së sigurisë për cilësinë. BMP mund të delegojë tek IEKA organizimin dhe realizimin e kontrollit të sistemit të cilësisë të audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit, të cilët auditojnë njësitë ekonomike jo me interes publik.

Kontrolli i sigurimit të cilësisë deri në momentin e ndryshimvet ligjore dhe hartimin e akteve rregullatore nga BMP, është organizuar nga IEKA nëpërmjet audituesve ligjorë. Sistemi aktual i vënë në funksion nga BMP në përputhje me kërkesat ligjore, aktet rregullatore si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, kryhet nëpërmjet inspektorëve të strukturës mbështetëse të cilët plotësojnë kriteret e larta ligjore profesionale dhe që nuk e ushtrojnë profesionin e AL. Në rastet e delegimit të këtij funksioni tek IEKA, procesi duhet të realizohet me po të njëjtat kriteret dhe rregulla të përcaktuara në ligj dhe këtë rregullore.

Një risi në këtë rregullore është fakti që në kontrollin e sigurimit të cilësisë është parashikuar realizimi i kontroleve të brendshme të cilësisë për angazhimet individuale të auditimit, me qëllim dhënien e një sigurie më të lartë përsa i përket zbatimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira në auditim. Politikat dhe procedurat e kontrollit të sigurimit të cilësisë kanë për qëllim të arrijnë përmirësime të rëndësishme në cilësinë e përgjithshme të praktikave të auditimit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë është i detyrueshëm për të gjithë subjektet që kryejnë auditimet e NIP. Në rastet e angazhimeve të auditimit sipas kushteve të nenit 42 pika 2 e ligjit për auditimin, duhet të garantohet sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë prej audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit të angazhuar. Kjo rregullore parashikon që në angazhimet e auditimit të NIP-ve të angazhohet gjithashtu një partner/auditues ligjorë për rishikimin e kontrollit të cilësisë.

Metodologjia e kontrollit të sigurimit të cilësisë është më e rëndësishmja për vetë misionin dhe natyrën e punës së BMP. Kjo metodologji është voluminoze dhe parashikon një detajim të të gjithë të dhënave dhe publikimeve që duhet të përmbajë dosja e audituesve ligjorë gjatë punës së tyre, në misionet e realizuara. E veçanta e kësaj metodologjie është se ka transpozuar pjesë të rëndësishme të rregullores 537 të BE, duke vijuar më tej me këtë proces. Kjo jo vetëm që do të ndikojë në vijimin e mëtejshëm të transpozimit, por edhe do të mundësojë përvetësimin e praktikave më të mira europiane për shërbimin e auditimit dhe cilësinë e shërbimit në interes të publikut.

### **3.3. Rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës**

Gjatë viti 2018, një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve në staf të BMP. Edhe pse organika e strukturës mbështetëse, për shkak të mungesës së burimeve të financimit dhe akteve rregullatore, u plotësua vetëm në tremujorin e fundit të 2018, gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet ekspertëve vendas dhe të huaj, si dhe partnerëve ndërkombëtarë janë zhvilluar një sërë sesionesh trajnimi dhe asistence teknike me stafin e strukturës mbështetëse. Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve ka qenë rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve inspektuese të inspektorëve të strukturës mbështetëse.

### **3.4. Provimet e aftësisë profesionale**

Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale është krijuar më 29.03.2018, në zbatim të nenit 17 dhe 18 të ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit ligjorë dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar. Ky komision ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe realizimin e testeve, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM.

KPAP menjëherë pas konstituimit ka kryer veprimtarinë e tij në zbatim të misionit të vet të përcaktuar nga ligji dhe nga aktet e tjera rregullatore, sikurse është:

- Rregullorja Nr. 2, datë 22.02.2018 “Për funksionimin e KPAP dhe të Mbiqëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për AL dhe KM”;
- Rregullorja Nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM”.

Disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara nga KPAP përmbledhen si më poshtë:

- U miratua në kohën e duhur kalendari i provimeve për sezonin e mbetur të vitit 2016 dhe për sezonin e vitit 2018 u organizua puna administrative nga IEKA, i cili përmes sekretarisë teknike publikoi informacionet, grumbulloi aplikimet dhe i përpunoi të dhënat në kohën e duhur.
- Bazuar në informacionet e përpunuara nga sekretaria teknike, KPAP miratoi listën e kandidatëve që plotësonin kriteret, dhe trajtoi e shqyrtoi me seriozitet dhe në përputhje me ligjin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore të miratuara nga BMP, kërkesat dhe ankesat e kandidatëve.
- Në lidhje me administrimin e procesit të testimit, KPAP, mori të gjitha masat e karakterit teknik dhe administrativ që provimi në të gjitha disiplinat të realizohej në kushte të barabarta për kandidatët, në përputhje me programin e miratuar, dhe sipas të gjitha kërkesave të ligjit 10091, dhe Rregulloreve për organizimin e procesit të provimeve.

Gjatë vitit 2018 u regjistruan një numër i konsiderueshëm kandidatësh për të marrë pjesë në provimet për AL dhe KM, nga të cilët kanë përfunduar me sukses dyk marrë titullin KM 71 kandidatë, dhe titullin AL 48 kandidatë. BMP ka bashkëpunuar ngushtë me KPAP duke organizuar me sukses këto dy sezona provimesh të aftësive profesionale, sezonin për provimet e mbetura të vitit 2016, si dhe sezoni për kandidatët e rinj të vitit 2018.

Datat e zhvillimit të provimeve paraqiten në tabelën më poshtë:

***Sezoni për provimet e mbetura të vitit 2016***


<b>Nr.</b>	<b>Displina</b>	<b>Data</b>
1	Zbatimi i modeleve të dhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike të biznesit (personave juridikë). Përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.	8 qershor 2018
2	Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë.	25 qershor 2018

***Sezoni i provimeve për vitin 2018***

<b>Nr.</b>	<b>Displina</b>	<b>Data</b>
1	Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar	11 korrik 2018
2	Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën	22 shtator 2018

	penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare.	
3	Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë.	20 tetor 2018
4	Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit.	17 nëntor 2018
5	Zbatimi i modeleve të dhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë). Përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.	8 dhjetor 2018

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e të dhënave të pjesëmarrjes dhe kalueshmërisë së procesit të pesë provimeve për vitin 2018.



## 4. Vështrimi i përgjithshëm mbi tregun e auditimit

### 4.1. Cilësia në auditim

Auditimi është një e mirë publike, ai i jep siguri palëve të interesuara për integritetin dhe cilësinë e informacionit financiar në tregun e kapitalit dhe formon bazën për vendim marrje në investime. Auditimi i ofron një siguri të arsyeshme drejtuesve të shoqërive mbi integritetin e shoqërisë. Një shoqëri e drejtuar mirë, transparente dhe e përgjegjshme nuk gjeneron vetëm kapital për të financuar më shumë investime, por i jep besim punonjësve që puna e tyre është e sigurtë dhe furnitorëve që do të paguhen në të ardhmen.

#### 4.1.1 Cilësia në auditim dhe përgjigja jonë

Në këtë raport janë publikuar disa nga gjetjet kryesore mbi rezultatet e inspektimit mbi shoqëri të auditimit dhe monitorimin e punës. Megjithëse ne kemi identifikuar shembuj të praktikave të mira, nga inspektimet tona u konstatua se cilësia e auditimit nuk është në nivele të tilla që të sigurojë një informacion cilësor shtesë për përdoruesit e pasqyrave financiare.

Progresi i këtij viti në drejtim të realizimit të objektivit publik të BMP është inspektimi për herë të parë i 10 shoqërive audituese dhe 15 angazhime individuale prej këtyre shoqërive të auditimit nën asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë, të përzgjedhura sipas metodologjisë së kontrollit të sigurimit të cilësisë.

BMP ka zhvilluar një strategji e cila bazohet në kontrollin e drejtpërdrejtë (me inspektime të vazhdueshme) për shoqëritë e auditimit/audituesit ligjorë të NIP, si dhe në monitorimin (mbikëqyrjen) e shoqërive të auditimit/audituesve ligjorë të mesëm dhe të vegjël. Vlen të theksohet, se ky proces kontrolli dhe monitorimi bazohet në një analizë risku, duke e fokusuar veprimtarinë e BMP në subjektet që paraqesin risk më të lartë.

Gjatë kontrolleve të cilësisë të vitit 2018 është krijuar një eksperiencë e çmuar e cila ka rritur kapacitetet teknike dhe efektivitetin e stafit.

Gjatë procesit të inspektimeve BMP i kushtoi rëndësi të madhe transparencës dhe diskutimit të hapur të gjetjeve me palët e përfshira në proces. BMP ka qenë i fokusuar për të identifikuar çështjet me rrezik më të lartë për interesin publik dhe ti adresojë ato në mënyrë të përshtatshme dhe me vendosmëri.

Në të njëjtën kohë nevoja për cilësi më të lartë të auditimit vjen gjithmonë e në rritje, edhe për shkak të nivelit më të lartë në pritshmëritë që ka vetë biznesi. Si rrjedhojë, aktet rregullatore,


metodologjitë e reja të miratuara nga BMP, si dhe zbatimi i tyre synojnë mbështetjen e cilësisë së lartë dhe praktikave më të mira të standardeve të auditimit, duke shkuar aq larg sa të mbrojnë audituesin në pavarësinë dhe në parandalimin e konfliktit të interesit që mund të ekzistojë në qoftë se një auditues është angazhuar në ofrimin e shërbimeve jo audituese për një njësi të audituar.

Nëse audituesit nuk mundën të tregojnë pavarësinë e tyre, ata nuk mund të trajtojnë perceptimin që mbajnë disa nga palët e interesit, duke u nxitur më shumë nga konsideratat e tyre tregtare, dhe shitjen e shërbimeve jo audituese sesa duke vepruar në interesin publik. BMP tashmë ka filluar punën duke parë efektivitetin e kërkesave ndaj audituesve në lidhje me punën që bëjnë për informacionin e publikuar, së bashku me pasqyrat financiare.

#### 4.1.2 Konkurenca në tregun e auditimit

Tregu i auditimit në Shqipëri është i përbërë, me rreth 126 auditues ligjorë (person fizik) dhe 64 shoqëri auditimi, me një total prej 208 auditues ligjorë të regjistruar në fund të vitit 2018.

Audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit ndërmarrin rreth 2.600 auditime ligjore në vit referuar të dhënave për angazhimet e realizuar në vitin 2018. Qarkullimi i përgjithshëm i vlerësuar nga të dhënat e disponueshme pranë BMP është 802 milion Lekë ose rreth 6,3 milion EURO.



Audituesit ligjorë kanë patur një qarkullim vjetor prej rreth 36% të auditimeve për pasqyrat financiare të vitit 2017, ndërsa shoqëritë audituese kanë realizuar një qarkullim prej rreth 64%.


Gjithashtu, është konstatuar se dhjetë shoqëritë më të mëdha audituese kanë audituar përafërsisht 80% të njësive ekonomike me interes publik të cilat kanë patur një peshë prej rreth 30% të tregut të auditimit për auditimet e pasqyrave financiare në fund të 2017.



Shërbimet e tjera të realizuara nga audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit zënë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat e tyre. Kështu, nga të dhënat e disponueshme për vitin 2018 rezulton që audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit kanë realizuar të ardhura në një vlerë prej rreth 1.108 milion Lekë ose rreth 8,7 milion EURO.

Ashtu si në angazhimet e auditimit shoqëritë audituese zenë peshën më të konsiderueshme me rreth 76% të të ardhurave në dhënien e shërbimeve të tjera.

Të ardhurat vjetore 2018  
shërbime tjera



Shërbimet e tjera përfshijnë: angazhime të dhënies së sigurisë si rritje kapitali, transformim, bashkim, ndarje, vlerësim aktivesh, ekspertiza gjyqate dhe të ngjashme; angazhime të rishikimit të informacioneve financiare historike, mbajtje kontabiliteti, përgatitje e pasqyrave financiare, konsulenca dhe të tjera të ngjashme.

## 5. Inspektime me fokus kontrollin e cilësisë

Gjatë vitit 2018, BMP zhvilloi inspektime në vend pranë 10 subjekteve të licencuara si auditues ligjor apo shoqëri audituese. Këto inspektime u zhvilluan bazuar në rregulloren për “Procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor” dhe SNKC 1 nën asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë. Ekspertët ndërkombëtarë ishin pjesë e projektit pilot “Përmirësimi i Cilësisë së Auditimit nëpërmjet forcimit të sistemit të mbikëqyrjes” (EQ-FINREP).

Objektivi i inspektimeve për rishikimin të cilësisë së auditimit është të sigurojë dhe promovojë përmirësimin në cilësinë e auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Rishikimi i cilësisë së auditimit vlerëson cilësinë e punës, procedurave dhe politikave të audituesve në angazhimet që ata ndërmarrin, veçanërisht pranë njësive ekonomike me interes publik (NIP).

Shoqëritë e auditimit dhe angazhimet e auditimit të shqyrtuara janë përzgjedhur bazuar në vlerësimin e riskut sipas metodologjisë së sipërpërmendur, si një risi e cila mbështetet në kriteret ligjore dhe praktiket më të mira ndërkombëtare.

Rezultatet e fazës së planifikimit janë të përmbledhura në tabelën më poshtë:

Tabela 1

Shoqëria e auditimit	Periudha e inspektimit	Nr. angazhimeve përzgjedhura për rishikim
<b>Ernst &amp; Young EKA</b>	17 - 18 Tetor & 9 Nëntor 2018	2
<b>KPMG</b>	5 - 6 Nëntor 2018	1
<b>PricewaterhouseCoopers Audit</b>	7 - 8 Nëntor 2018	3
<b>Deloitte Audit Albania</b>	20 - 21 Nëntor & 12 Dhjetor 2018	2
<b>Grand Thornton Albania</b>	13 - 14 Nëntor 2018	2
<b>Mazars</b>	15 - 16 Nëntor 2018	1
<b>BDO Albania</b>	3 - 5 - 12 Dhjetor 2018	1
<b>Filto Auditing</b>	11 Dhjetor 2018	1
<b>Financial Consulting Studio K&amp;L</b>	13 Dhjetor 2018	1
<b>Telo Auditing</b>	18 - 19 Dhjetor 2018	1

Procesi i kontrollit u zhvillua sipas fazave në vijim:

**Kryerja e kontrollit:** Në këtë fazë është realizuar vizita në shoqërinë e auditimit, duke filluar me një takim fillestar me personelin kryesor të shoqërisë së auditimit. Inspektorët në këtë takim kanë prezantuar në mënyrë të përmbledhur qëllimin e kontrollit, kohëzgjatjen e parashikuar të punës pranë shoqërisë, është konfirmuar marrja e informacionit të kërkuar, mjetet në dispozicion për kryerjen e këtij kontrolli (sallë, akses në sisteme dhe databaza etj). Gjatë kësaj faze u zhvilluan diskutime mbi politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë, veçanërisht mbi zbatimin e programit të monitorimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë, përfshirë rezultatet nga monitorimet dhe kontrollet e kryera së fundmi, si edhe planet e vitit në vijim.

Procesi i punës vijoi me kontrollin e elementëve të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë, si janë adresuar këto elementë në politikat dhe procedurat e shoqërisë, pajtueshmërinë e politikave dhe procedurave me standardin ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë (SNKC1), me standardet ndërkombëtare të auditimit, kodin e etikës, me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e tyre në angazhimet e auditimit të përzgjedhura.

**Raportimi:** Në përfundim të kryerjes së kontrollit është zhvilluar një takim përmblyllës ku janë diskutuar gjetjet kryesore me drejtuesit dhe personat përgjegjës për kontrollin e cilësisë. Faza e parë e raportimit konsiston në përgatitjen e draft raportit dhe planit të veprimit, të cilat i janë komunikuar zyrtarisht shoqërisë së auditimit për koment. Në fazën e dytë të raportimit adresohen komentet e shoqërive të auditimit nëpërmjet diskutimeve të gjata dhe konstruktive midis shoqërisë së auditimit dhe inspektorëve të BMP-së, për të garantuar një proces transparent dhe të pa anshëm. Procesi i kontrollit finalizohet me dërgimin e raportit final dhe planit të veprimit, si pjesë përbërëse e këtij raporti.

Realizimi i procesit të kontrollit ka pasur sfida të shumta nga të cilat do të veçonim:

- Vështirësi në marrjen në kohë të informacionit mbi politikat dhe procedurat në zbatim nga shoqëria e përzgjedhur për kontroll.
- Paraqitje e pjesshme e informacionit në lidhje me shërbimet e auditimit dhe shërbimet e jo auditimit të ofruara klientëve.
- Në përgjithësi nuk janë dhënë informacione në lidhje me orët e buxhetuara kundrejt orëve aktuale të shpenzuara, të shoqëruara me tarifat përkatëse për të gjitha angazhimet. Në rastet kur ky informacion është paraqitur ka qënë vetëm për angazhimet e përzgjedhura për kontroll.

Paraprakisht javën e tretë të tetorit, në kuadër të ndërgjegjësimit mbi procesin e inspektimit u realizuan takime individuale me të gjitha subjektet e zgjedhura, për të vlerësuar nëse ata kanë kuptuar drejt këtë proces, si dhe për të promovuar një mjedis bashkëpunues.

Programi i kontrollit është realizuar nëpërmjet:

- Kontrollit të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë së shoqërisë.
- Kontrollit të cilësisë të angazhimeve të auditimit (NIP/Jo-NIP) të përzgjedhur.

Për rrjedhojë, edhe gjetjet kryesore si rezultat i procesit të kontrollit në dhjetë shoqëri të auditimit janë të ndara në:

- Gjetje të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë së shoqërisë.
- Gjetje të angazhimit të auditimit.

### **5.1. Gjetje të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë**

Më poshtë janë paraqitur gjetjet kryesore të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë të grupuara sipas nënçështjeve më poshtë.

#### ***5.1.1 Rishikimi i sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë në nivel të shoqërisë së auditimit dhe angazhimit të auditimit***

- Subjekt i procesit të rishikimit të cilësisë është partneri i rrjetit dhe jo audituesi ligjor.
- Zbatim i pjesshëm i rishikimit të kontrollit të cilësisë për NIP-e të klasifikuara sipas legjislacionit lokal.
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë brenda shoqërisë së auditimit duhet të kryhet nga një auditues ligjor.
- Mospajtueshmëri me politikat e brendshme përsa i përket ndarjes së roleve të partnerit drejtues të shoqërisë dhe oficerit të etikës.
- Zbatimi i instrumentave të monitorimit të sistemit të kontrollit të cilësisë në nivel rajonal dhe jo në nivel individual të shoqërive anëtare.
- Mungesë e formalizimit apo e zbatimit të procedurave të monitorimit për rishikimet e cilësisë (cold review) së angazhimeve.
- Evidenca në dosjen e angazhimit tregon që procesi i rishikimit të programit të auditimit, letrave të punës dhe evidencës së auditimit, nga partneri i angazhimit dhe partneri i rishikimit është realizuar pranë datës së lëshimit të raportit. Kjo metodë nuk jep siguri se procesi i rishikimit ndodh përgjatë procesit të auditimit.

### **5.1.2 Mbledhja, arkivimi dhe ruajtja e dosjes së angazhimit**

- Sistemi i arkivimit në shoqëritë audituese të inspektuara përfshin arkivimin pjesërisht në sistemet e tyre TIK /platformat e auditimit dhe pjesërisht në dosjet fizike. Në gjashtë nga dhjetë shoqëritë e auditimit ky sistem nuk ofron siguri përse i përket plotësisë së dosjes së angazhimit dhe arrijen në të njëjtat konkluzione me ekipin e auditimit nëse dosja e angazhimit do të ishte objekt rishikimi prej një pale të tretë të autorizuar.
- Shoqëritë e auditimit me praktikues të vetëm nuk kanë një sistemi arkivimi të përshtatshëm i cili të ofrojë pajtueshmëri me SNKC1 dhe me praktikatat më të mira të arkivimit.

### **5.1.3 Struktura e burimeve njerëzore**

- Mungon roli i audituesit me eksperiencë / mbikëqyrësit.
- Pranimi/vazhdimi i angazhimeve të auditimit, për njësitë ekonomike me aktivitet kompleks, nga shoqëritë audituese me një strukturë të pamjaftueshme të burimeve njerëzore.

### **5.1.4 Të ndryshme**

- Në dy raste nuk është publikuar raporti i transparencës në faqen zyrtare të internetit.
- Në dy raste të tjera nuk është njoftuar autoriteti mbikëqyrës dhe organizata profesionale brenda afateve të parashikuara në rastet e ndërprerjes së angazhimit të auditimit.

## **5.2. Gjetje të anagazhimeve individuale**

Ekipi i inspektimit ka vlerësuar cilësinë e përgjithshme të çdo auditimi individual të rishikuar. Janë shqyrtuar aspektet e kontrollit të cilësisë dhe zbatimi i procedurave në të gjitha angazhimet e auditimit që janë kontrolluar.

### **5.2.1 Parakushtet për pranim/vazhdim të klientit/angazhimit të auditimit**

#### Pavarësia

- Përdorimi i deklaratave të përbashkëta të pavarësisë prej ekipit të angazhimit dhe jo deklarata individuale të pavarësisë.
- Mungesë e deklaratës së pavarësisë nga ekspertët e angazhuar në ekipin e auditimit.

#### Pranimi/vazhdimi i angazhimit

- Mangësi në formën e pranimit/vazhimit të angazhimit të auditimit përsa i përket dokumentimit të kërkimeve dhe njohjes së klientit dhe kërkimeve mbi kontrollin e konfliktit të interesit dhe pavarësisë nga klienti.
- Mos zbatim në kohën e duhur të procedurave të pranimit/vazhimit të angazhimit.
- Letra e angazhimit ka patur gabime dhe mangësi në përmbajtje.

### **5.2.2 Vlerësimi i riskut dhe përgjigjia ndaj riskut të vlerësuar**

- Përcaktim i nivelit të riskut të angazhimit pa arsyetim të mjaftueshëm të dokumentuar.
- Përzgjedhje e kriterëve cilësorë duke bërë një klasifikim të papërshtatshëm të njësisë ekonomike (madhësisë dhe kompleksitetit) që ka ndikuar më tej në hartimin e strategjisë së përgjithshme të auditimit.
- Është konstatuar dokumentim jo i plotë përsa i përket kërkimeve me drejtimin mbi çështje të ndryshme si zbatimi i parimit të vijimësisë, transaksionet me palët e lidhura, vetëvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm etj (mungesë e të dhënave mbi takimin, palët pjesëmarrëse, feedback mbi çështjet e diskutuara).
- Në disa raste ka munguar dokumentimi i konkluzionit mbi vetëvlerësimin e njësisë ekonomike përsa i përket sistemit/strukturave të kontrollit të brendshëm në lidhje me rrezikun e mashtrimit dhe gabimit. Në të tjera raste është konstatuar një analizë e pjesshme e faktorëve të rrezikut për shkak të mashtrimit dhe gabimit.
- Dokumentim jo i plotë i aspekteve që lidhen me përdorimin e parimit të vijimësisë dhe e shqyrtimit të përshtatshmërisë së procedurave të kontrollit mbi regjistrimin dhe autorizimin e transaksioneve me palët e lidhura.
- Mangësi në kryerjen e procedurave të rishikimit analitik paraprak.

- Mangësi në dokumentimin apo kryerjen e procedurave të auditimit mbi verifikimin e pohimeve të zërave të pasqyrave financiare (si të ardhurat, llogaritë e pagueshme, për rekuperimin e llogarive të arkëtueshme, për investimet, mbi angazhimet dhe detyrimet e paparashikuara (commitments and contingencies).
- Mos aplikimi korrekt i procedurave të “cut-off” mbi pohimet e klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve nëse janë regjistruar në periudhën e duhur kontabël.
- Procedurat e ngjarjeve të mëvonshme nuk janë adresuar në kohën e duhur apo nuk janë kryer.

### **5.2.3 Raportimi**

- Mangësi në përdorimin e listave të kontrollit mbi paraqitjen e pasqyrave financiare dhe shënimet shpjeguese dhe listave të kontrollit përfundimtar.
- Në një rast është vërejtur që data e lëshimit të opinionit është para firmosjes së pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Komunikimi me personat e ngarkuar për drejtimin.
- Mangësi në formë e letrës së drejtimit (ka qënë në draft, e pa firmosur nga partneri i angazhimit, nuk i është drejtuar bordit të drejtorëve).
- Nuk është kryer komunikimi me komitetin e auditimit të shoqërisë.
- Letra e përfaqësimit (në disa raste mban datën pas lëshimit të opinionit, në disa raste ka munguar).

## 6. Rekomandime për audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit

Në përfundim të procesit të kontrollit dhe sfidave të ndeshura e konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë rëndësinë që merr në mbarëvajtjen e këtij procesi plotësia, aksesit, forma dhe sigurimi në kohë dhe pa kufizime i informacionit.

### 6.1. Rekomandime për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë

- Rekomandohet që audituesit ligjorë / shoqëritë e auditimit të rishikojnë politikat e brendshme në përputhje me kërkesat e standardeve dhe atyre ligjore në përcaktimin e kriterëve për kualifikimin e angazhimeve të auditimit për rishikimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë (EQCR) në nivel angazhimi.
- Rekomandohet që procesi i vlerësimit dhe planifikimit për EQCR në fillim të sezonit të auditimit dhe konsultimin e tij në nivel të rrjetit të dokumentohet.
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit të rishikojnë procedurat e brendshme të monitorimit, përsa i përket përzgjedhjes për rishikim të angazhimeve të auditimit, në mënyrë që përzgjedhja të jetë sa më përfaqësuese.
- Shoqëritë e auditimit sugjerohet të zbatojnë politikat dhe procedurat e brendshme si edhe të sigurojnë pajtueshmërinë e politikave të rrjetit me legjislacionin lokal. Në këtë proces së bashku me kriterin e përcaktimit të partnerit të rrjetit duhet të mbahet parasysh rishikimi i audituesit ligjor, pasi është ai përgjegjës përpara ligjit për nënshkrimin e opinionit të auditimit.
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit të analizojnë mundësinë për të ndryshuar / përmirësuar platformën e auditimit/sistemin e dokumentimit me qëllim adresimin e riskut në lidhje me ndërhyrjen e paautorizuar në fletët e punës. Si një alternativë do të rekomandonim që shoqëritë e auditimit të ndërtojnë procedura alternative kontrolli të brendshme për të siguruar që ndryshimet e mëpasme të mos jenë të pa autorizuara.
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit të dokumentojnë në mënyrë koherente dhe të ndërlidhur në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet referimit të ndërsjellë konkluzionet përgjatë fazave të ndryshme të auditimit.
- Në kushtet kur shoqëritë e auditimit me praktikues të vetëm marrin përsipër angazhime të njëjësive ekonomike me interes publik, edhe pse me statusin e praktikuesit të vetëm, ata duhet të zhvillojnë politika/ procedura të tilla që të sigurojnë njohjen, kuptueshmërinë dhe zbatimin e kërkesave të SNKC1 si dhe të dokumentojnë zbatueshmërinë e tyre.



- Audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit rekomandohet të mbajnë dhe sigurojnë informacionin mbi orët e buxhetuara dhe faktike dhe ky informacion të jetë i plotë dhe i saktë. Ky informacion duhet të përdoret për qëllime planifikimi në periudhat pasardhëse si dhe në buxhetimin (tarifat) për angazhimet pasardhëse.
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit të hartojnë një listë me minimumin e dokumentave që duhet të përmbajë një dosje angazhimi, dhe të realizojnë një proces kontrolli përpara se këto dokumente të arkivohen në dosje fizike apo format elektronik brenda afatit 60 ditor siç përcaktohet nga standardi. Nëse blerja apo përdorimi i një platforme të tillë elektronike nuk është efiçente ekonomikisht, në veçanti për praktikuesit e vetëm, do të rekomandonim arkivimin e dokumentave në një format elektronik të pamodifikueshëm psh. PDF apo ruajtja e tyre në CD, dhe ky i fundit të ruhet në një vendodhje ku aksesimi të jetë i kontrolluar. Për dokumentat të cilët për shkak të madhësisë nuk mund të ruhen në format elektronik, do të rekomandonim të përgatitet një listë kontrolli nëpërmjet të cilës dokumenti i procedurës së auditimit elektronik të mund të lidhet me dokumentin fizik në dosjen ku është arkivuar. Audituesi duhet të krijojë sisteme arkivimi të tilla që të jenë në përputhje me kërkesat e parashikuara në SNKC1 në lidhje me arkivimin, ruajtjen dhe aksesimin e këtyre dokumentave.
- Audituesit ligjor ose shoqëritë e auditimit të cilat angazhohen në auditime të njëjësive me interes publik, bazuar në ligjin për auditimin, duhet të hartojnë dhe publikojnë brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar një raport për transparencën. Ky raport duhet të publikohet në faqen e internetit të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese dhe duhet të të trajtojë çështjet/seksionet si parashikohen nga ligji për auditimin. BMP inkurajon të gjithë shoqëritë e auditimit të hartojnë raporte të cilat japin më shumë informacione dhe një pamje të vertetë të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë të shoqërisë së auditimit.

## **6.2. Rekomandime për angazhimet e auditimit**

- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit, veçanërisht ato të cilat drejtohen nga praktikues të vetëm, të punësojnë ose të bashkëpunojnë me auditues ligjor të tjerë / shoqëri auditimi për të mbështetur auditimin e njëjësive ekonomike me interes publik ose të njëjësive ekonomike të mëdha dhe me aktivitet kompleks.
- Praktikrat më të mira inkurajojnë mbajtjen e minutave të takimeve si një mjet për dokumentimin e diskutimeve për çështje të ndryshme si zbatimin e parimit të vijimësisë, transaksionet me palët e lidhura, vetëvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, mjedisit ligjor dhe rregullator etj.

- Audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit rekomandohet të vendosin linja komunikimi me komitetin e auditimit. Ky komunikim duhet të dokumentohet në dosjen e auditimit.
- Rekomandohet që shoqëritë e auditimit me praktikues të vetëm të kryejnë dhe dokumentojnë procedura auditimi për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar rreziqet e anomalive materiale, që burojnë nga paraqitja në mënyrën e gabuar, në pasqyrat financiare të marrëdhënieve, transaksioneve apo tepricat e llogarive me palët e lidhura siç edhe kërkon kuadri rregullator. Vlerësimi nga ana e ekipit të angazhimit mbi “përshtatshmërinë e procedurave të kontrollit mbi autorizimin dhe regjistrimin dhe transaksionet me palët e lidhura” duhet të jetë pjesë e dokumentimit dhe në bazë të kësaj kuptueshmërie dhe vlerësimi audituesi duhet të përcaktojë edhe shtrirjen e procedurave të auditimit.
- Rekomandohet ndjekja e praktikave më të mira për procesin e verifikimit të pajtueshmërisë së paraqitjes së pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese më kuadrin raportues financiar duke përdorur listat e kontrollit përfundimtar (completion checklist/memorandum) dhe listat e kontrollit mbi paraqitjen e pasqyrave financiare dhe shënimet shpjeguese (disclosure check-list).
- Format i opinionit të auditimit rekomandohet të paraqitet sipas parashikimeve të standardeve të auditimit dhe kërkesave ligjore. SNA 700 përcakton se raporti i audituesit duhet të identifikojë (i) njësinë ekonomike pasqyrat financiare të së cilës janë audituar dhe periudhën e raportimit të këtyre pasqyrave (ii) të deklarojë që pasqyrat financiare janë audituar; (iii) të identifikojë titullin e secilës pasqyrë dhe shënimet shpjeguese pjesë përbërëse e pasqyrave financiare përfshirë përmbledhjen e politikave kontabël më të rëndësishme; (iv) të përmbajë datën e nënshkrimit të opinionit dhe emrin e partnerit të angazhimit/audituesin ligjor.

## 7. Masat e marra ndaj subjekteve të ndryshëm

Përgjatë vitit 2018 BMP në kuadër të veprimtarisë rmbikëqyrëse dhe rregulluese të përcaktuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe Rregullores Nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore” mori në shqyrtim propozimet e Këshillit Drejtues të IEKA për marrjen e masave disiplinore. BMP ka shqyrtuar dy raste për marrjen e masave disiplinore për shoqëri auditimi.

Në mbledhjen e tij me datë 02.10.2018 pas shqyrtimit të dy propozimeve dhe pas ballafaqimit midis anëtareve të Bordit dhe dy subjekteve u vendos:

- Në njërin prej këtyre rasteve nuk kanë rezultuar rrethanat sipas të cilave të jetë e nevojshme marrja e masave disiplinore.
- Në rastin tjetër BMP, bazuar në rrethanat dhe faktet e shqyrtuara, ka marrë për herë të parë vendimin me masë disiplinore vendosje gjobë në vlerën monetare 85 000 lek për mosdhënie informacioni për qëllime të kontrollit të cilësisë.

## 8. Planifikimi

### 8.1. Plani i punës 2019

#### 8.1.1 Janë draftuar dhe planifikuar të miratohen rregullore të reja.

#### **Rregullore për rregullimin dhe mbikëqyrjen e organizatave profesionale të kontabilitetit**

Është draftuar rregullorja për “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”. Kjo rregullore do të ketë për qëllim rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të tij si dhe mbikëqyrjen e funksionimit të Organizatave të Kontabilistëve të Miratuar.

Në të parashikohet të paraqitet procesi i monitorimit të edukimit të vijueshëm të KM që ushtrojnë profesionin si dhe atyre profesionistëve që kanë fituar titullin si KM të cilët nuk janë ushtrues të profesionit, së bashku me procedurat e regjistrimit në regjistrin publik të organizatave profesionale.

Në këtë rregullore parashikohet gjithashtu të hartohen rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen e procesit të edukimit të vijueshëm, si dhe plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të kontabilistëve të miratuar, si dhe procesin e mbikëqyrjes së organizatave profesionale të KM.

Draft rregullorja i është dërguar për komente dhe sugjerime palëve të interesuara në muajin dhjetor 2018.

#### **Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial”**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat organizative e teknike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe asgjësimin e informacionit konfidencial nga objekti i veprimtarisë së BMP.

Ajo parashikohet të zbatohet për të gjitha të dhënat e përpunuara nga BMP në përputhje Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Kjo rregullore do të zbatohet për përpunimin e të dhënave konfidenciale

plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet veprimtarisë së BMP. Të dhënat e shpërndara nga burimet e disponueshme publikisht nuk do të vlerësohen konfidenciale.

### **8.1.2 Kontrolli i cilësisë**

Përgjatë vitit 2019 kontrolli i cilësisë është planifikuar të zhvillohet në dy faza. Faza e parë parashikohet të zhvillohet në muajt Maj-Korrik dhe faza e dytë Tetor-Dhjetor 2019.

Janë planifikuar të përzgjidhen rreth 15 inspektime deri në fund të vitit 2019 të cilat do të zhvillohen bazuar në

në rregulloren për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor. Sipas rregullores, njësitë ekonomike me interes publik duhet të renditen çdo vit sipas nivelit të riskut, të vlerësuar bazuar në analizën e vlerësimit të riskut. Bazuar në këtë renditje, procesi i përvitshëm i përzgjedhjes së angazhimeve të auditimit për sigurimin e cilësisë kryhet sipas kësaj radhe:

- a) Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit mbi bazën ciklike.
- b) Përzgjedhja e angazhimeve të auditimit, të cilat kërkojnë kontrolle shtesë për shkak të një treguesi risku specifik të lartë, pavarësisht kontrolleve të kryera në kuadër të ciklit.

Kontrolli i sistemit të cilësisë përfshin edhe të gjithë audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit, të cilët auditojnë njësi ekonomike jo me interes publik.

### **8.1.3 Mbikëqyrja e kontabilistëve të miratuar dhe rregullimi i tyre**

Në kuadër të rregullimit dhe mbikëqyrjes së profesionit të KM të parashikuar në draft rregulloren pritet të realizohet një punë intensive e stafit të BMP në procesin e verifikimit të KM-ve.

Mbikëqyrja e Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar do të bëhet nga inspektorët përkatës të BMP-së në pajtim me kuadrin rregullator të BMP. OP-të do të jenë të detyruara të vënë në dispozicion të inspektorëve të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili mundëson mbikëqyrjen e funksionimit dhe pajtueshmërinë me dispozitat ligjore në fuqi.

Mbikëqyrja e OP-ve do të bëhet sipas një kalendari pune të brendshëm në të cilin përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e SM që do jetë pjesë e grupit të inspektimit. OP do të jenë të detyruara të dorëzojnë pranë SM informacionin e kërkuar në mënyrë fizike pranë zyrave të BMP, ose përmes postës elektronike zyrtare të BMP. Inspektimi përfshin verifikimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të OP-ve të kryer në përputhje me standardet e IFAC.

BMP do të publikojë listën e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohura prej tij në faqen zyrtare dhe do ta përditësojë atë vazhdimisht për çdo ndryshim të mundshëm.

BMP do të publikojë në faqen e tij zyrtare regjistrin e konsoliduar të KM.

#### ***8.1.4 Trajnime të ndryshme për zhvillimin e stafit***

BMP ka parashikuar trajnimin e stafit me qëllim rritjen e mëtejshme të aftësive të tyre profesionale në kuadër të veprimtarisë mbikëqyrëse.

Janë parashikuar të realizohen gjithashtu pjesëmarrje në takime dhe seminare të Forumit Ndërkombëtar të Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR), në të cilin BMP është anëtar me të drejta të plota, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave me shtetet anëtare dhe marrjen e njohurive më të mira në realizimin e kontrollit të sigurimit të cilësisë. IFIAR është themeluar në 2006 dhe përbëhet nga rregullatorë të pavarur nga 52 juridiksione nga Afrika, Amerika Veriut, Amerika Jugut, Asia, Oqeania, dhe Europa. Misioni i IFIAR është t'i shërbejë interesit publik dhe të përmirësojë mbrojtjen e investitorëve duke rritur cilësinë e auditimit.

#### ***8.1.5 Bashkëpunime me institucione të tjera***

BMP do të luajë rol aktiv për bashkëpunimin me institucione të tjera të tilla si, DPT, QKB, KKK dhe institucione të tjera rregullatore me qëllim realizimin e vizionit mbikëqyrës.

Gjatë vitit 2019 është parashikuar të zhvillohet mëtej bashkëpunimi ndërmjet BMP-së dhe rregullatorëve financiarë (Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) me fokus në çështjet e auditimit. Ky bashkëpunim ka si qëllim përcaktimin e objektivit të përbashkët të këtyre autoriteteve për bashkëpunim ndërmjet tyre dhe për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit për të patur një cilësi më të mirë të auditimeve të njësive ekonomike me interes publik (NIP) në sektorin financiar.

Bashkëpunime të tjera do të synohen të realizohen gjithashtu me shoqatën e bankave dhe me institutin e audituesve të brendshëm (AIIA) me qëllim arritjen e një mbikëqyrje sa më efektive efciente, dhe transparente.

Gjatë vitit 2019 BMP parashikon të kryejë inspektime të përbashkëta me DPPPP për të krijuar njohuritë e nevojshme në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

### **8.1.6 Aktivitete të tjera**

Gjatë vitit 2019, parashikohet angazhimi i stafit të strukturës mbështetëse, në bashkëpunim me sekretarinë teknike të KPAP, për realizimn me sukses të sezonit provimeve të aftësive profesionale për vitin 2019.

Gjithashtu, stafi i strukturës mbështetëse do të angazhohet në aktivitetet administruese, në mbështetje të mbarëvajtjes së veprimtarisë së BMP në funksion të realizimit të objektivave.

*Ky raport është përgatitur vetëm për informaciontë përgjithshëm. BMP nuk pranon asnjë përgjegjësi ndaj ndonjë pale për humbje, dëmtime ose shpenzime, pavarësisht nëse janë në kontratë, kundërvajtje ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ndonjë veprim apo vendim i marrë (ose jo), si rezultat i ndonjë personi që mbështetet në këtë raport ose e përdor gjetje të pasqyruara në të.*